



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJORË MAT

Vendim

Nr. 28 Date 22.02.2017

“Për

“Dhënie mendim për përdorim të rezervës ujore për energji elektrike për HEC “ Fushë-Arrëz ”, Lumi Fan i Madh , degë e lumit Mat / Subjekti “Alesio 2014” sh.p.k”.

- Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50 pika 2, 51 dhe nenit 52 ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore”, si dhe **nenit 24 pika c** të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, me propozim të A.B.U. Mat:

Këshilli i Basenit Ujor Mat,

Vendosi:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**Alesio 2014**” shpk, me Administrator Z.Anton Gjinaj, për “Përdorim Rezerva Ujore për Energji Elektrike “ sipas studimit të paraqitur nga subjekti “Alesio 2014” shpk, me keto të dhëna:

Hec “ Fushë-Arrëz ”

- Prurja mesatare 3.96 m³/sek
- Prurja llogaritese 5.139m³/sek
- Kuota e aksit të vepres së marrjes: Z- 543m.n.d X -42 02 86.66 Y- 46 58 180.95
- Kuota e godines së HEC-it Z - 490 m.n.d X- 41 80 70.63 Y- 46 56 657.16
- Fuqia e instaluar 1990 kw
- Kapaciteti prodhues mesatar 7.115.721Kwh

2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes, i furnizimit me uje të popullatës etjere nga përdorimi i ujit për energji elektrike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjehere.


PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT

Ast NIKOLLA



KRYETARI I K.B.U. MAT

Eduard NDRECA



239